



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/09/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga L.TH ndaj gjyqtarit S.S, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 13.06.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga L.TH ndaj gjyqtarit S.S për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Pala L.TH me datë 22.05.2024 ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit S.S me pretendime për shkelje disiplinore, ku me datë 31.05.2024 lidhur me ankesën është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës në shkresën e tij është ankuar për shkelje të procedurave të gjykimit, veprime diskriminuese, trajtim jo të barabartë, mungesë të pavarësisë, transparencës dhe paanshmërisë nga punonjësit e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas tij në kundërshtim me nenin 30 pika (1) Kapitulli II të Drejtat dhe Liritë Themelore të rregulluar me Kushtetutë të Republikës së Kosovës është ngritur aktakuzë ndaj tij me datë 28.08.2023 me numër të lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë -----, ku pas dy dite me datë 30.08.2023 Gjykata Themelore në Prishtinë me urdhër ndëshkimor me të cilin e ka shpallur fajtor për veprën penale “ Ngacmim , pa qenë fare në dijeni ose i informuar për veprën penale dhe shkakun e akuzës. Sipas tij tij, është ngritur aktakuza dhe jam gjykuar dhe dënuar pa qenë fare i informuar me procesin, ku kjo përveç se përbën shkelje të detyrave të njeriut që rregullohen me Kushtetutë, njëkohësisht është shkelur edhe Kodi i Procedurës Penale neni 209 par. 1, 2, 239 par 1. Tutje sipas tij në aktakuzë prokurori ka deklaruar se ndaj të pandehurit janë përmbushur obligimet konform nenit 244 të KPRK-së, mirëpo kjo nuk qëndron sepse nuk kam qenë në dijeni fare se është ngritur aktakuza. Tutje ka deklaruar se gjyqtari i rastit me stafin mbështetës nuk janë mjaftuar vetëm me shpalljen fajtor përmes një aktakuze për të cilën nuk kam qenë në dijeni, por me datë 18.10.2023 nga zyra e institucionit ku i njëjti punon “-----“ ka pranuar Aktgjykimin me nr. 2023:182371, me të cilin është shpallur fajtor për veprën penale “ Ngacmim”, i cili është protokolluar në arkivin e ----- me nr.7009 të datës 18.10.2023, ku ky veprim është në kundërshtim me KPP nenin 474 par. 1, 475,476,477 par. 2, 3 dhe 6. Tutje

ka deklaruar se me këtë veprim zyrtarisht e kanë shpallur aktgjykimin si të formës së prerë, sepse kanë njoftuar autoritetin ku i njëjti punon për veprën penale për të cilën është dënuar. Sipas tij gjykata ka pasur adresën me të dhënat e sakta por pavarësisht kësaj aktgjykimin e kanë sjellë në punë, përmes një shënimi shtesë të dikujt tjetër, ku sipas zyrtares së arkivës së ----- e cila e ka pranuar zarfi ka qenë i hapur, ku me këtë është shkelur neni 199 par.1,4 i KPRK-së, ku në zarf shkruan se është dërgesë personale. Sipas tij, duke qenë fytyrë publike dhe duke ushtruar detyrën e zëdhënësit, gjykata ka pasur të gjitha mundësitë që në çdo kohë ta kontaktoj sepse me një kërkim të thjeshtë të dhënat e të njëjtit gjenden në google por edhe në webi nzyrtar të ----- it.

Sipas tij, nga këto që janë thënë më lartë, gjykata ka zhvilluar një proces të orkestruar për të dëmtuar reputacionin e tij si person publik, duke shkelur mbi të gjitha parimet dhe normat për ruajtje të fshehtësisë në proces, njëkohësisht ka shkelur edhe parimin e prezumimit të pafajësisë deri në vendimin e plotfuqishëm.

Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij ka deklaruar se duke qenë i shqetësuar nga kjo formë e përndjekjes së drejtësisë dhe posa ka kuptuar emrin e gjyqtarit të çështjes dhe bashkëpunëtorit profesional, ka shkuar në zyrën e gjyqtarit, ku fillimisht sipas tij gjyqtari ka shprehur habi se si nuk ka qenë në dijeni për aktakuzën dhe për këto çështje ti drejtohet Prokurorisë Themelore gjegjësisht prokurorit të rastit. Më tej, parashtruesi i ankesës ka deklaruar se personat që punonin në këtë zyre i kishte parë diku tjetër, duke kuptuar kështu që sipas tij gjykata këto lëshime nuk i ka bërë me rastësi.

Tutje ka deklaruar se në seancën e datës 09.02.2024 kishte ftuar disa media dhe gazetar në seancë të cilët ishin në dijeni për veprën penale për të cilën i njëjti akuzohej, dhe krejt kjo duke marrë parasysh se gjykata kishte bërë publik aktgjykimin ndaj tij andaj duke qenë i bindur se gjykimi do të jetë i hapur në frymën e transparencës, mirëpo në nisje të seancës së datës 09.02.2024 në procesverbal shkruan se shqyrtimi gjyqësor është i mbyllur, ku mbyllja e seancës ndodhi në kundërshtim me KPP nenin 289 par. 1, ku në marrëveshje ose dakordësi të fshehtë nga i pandehuri gjyqtari kishte mbyllur seancën. Në lidhje me këtë veprim, sipas tij gjyqtari nuk ka nxjerrë aktvendim për mbyllje të seancës me të cilin veprim ka pamundësuar të drejtën për ankimim të paraparë me nenin 291 par. 2.

Sipas tij, edhe pse seanca ishte e mbyllur pa respektuar procedurën, gjyqtari z. S.S e ka vu në lajthim gjatë shqyrtimit ku në seancë fillimisht i ka lejuar incizimin me telefon, për mbrojtjen më efikas dhe e ka njoftuar se çdo publikim pa autorizim bie mbi barrën e personit që bënë shkelje. Pas ankesës së përfaqësueses të të dëmtuarës gjyqtari vendos për ndërprerje të seancës dhe autorizon prokurorin që të shikojnë se i njëjti a ka bërë vepër penale, ku pastaj e marrin policia prezent që të shkoj për intervistim. Sipas tij, ky veprim përveç se shkel normat ligjore, njëkohësisht bie ndesh me të gjitha vlerat morale e njerëzore, ku në gjuhën popullore i bie me të pre në besë e në konak, ku sipas tij ishte i vetmi përball të gjithëve dhe kishte vetëm telefonin për të pasur si dëshmitar.

Parashtruesi i ankesës tutje ka deklaruar se punonjësit e GTHP-së kanë vendosur që të barikadohen në procesin gjyqësor ndaj tij, ku si asnjëherë më parë dhe në kundërshtim me parimin e kushtetutës nenin 102 par. 2 3 shprehimisht e kanë deklaruar veten si palë në proces, ku i njëjti sipas legjislacionit ka kërkuar disa të dhëna publike, ku GJTHP në kundërshtim me KPP neni 19 par. 1.15, zyrtarin e punësuar në zyrën e gjyqtarit z. S.S e konsiderojnë palë në

procedurën gjyqësore në rastin tim. Tutje ka deklaruar se zyrtarët e gjykatës të inatosur dhe frusteruar me kërkesën të apeluar pranë autoritetit AIP, në tentim për moszbatim të ligjit nga vetë organi që është i thirrur për mbikëqyrjen e zbatimit, bëjnë veprë penale sipas KPRK-së neni 98 par. 2 dhe shkelje disiplinore, ku ndajnë të dhënat për procesin e tij gjyqësor duke përfshirë edhe veprën për të cilën akuzohet, emrin mbiemrin e plotë në kundërshtim me KPP 237 par.1, ku sipas tij kanë mundur të refuzojnë ose apelojnë vendimin e AIP-së pa i ndarë me ta komplet të dhënat për procesin gjyqësor, kjo sepse sipas tij në një anë punonjësit e GJTHP-së luftojnë për gjykim me masa të fshehta dhe nën seanca të mbyllura dhe në anën tjetër krejt aktakuzën e shpërndajnë në komunikime të brendshme dhe të jashtme me këdo.

Në fund, ndër të tjerash ka deklaruar se procesi gjyqësor ndaj tij është duke u zhvilluar në kundërshtim me aktin më të lartë juridik shtetërorë e që është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. I njëjti ka kërkuar mbështetje që të sigurohet një proces i drejtë e i paanshëm, transparent dhe pa diskriminim, mos të lejohen persona që për inate a po konflikte te personale ta përdorin gjykatën.

Ndërsa, parashtruesi i ankesës me datë 24 Maj 2024 pas dorëzimit të ankesës disiplinore, përmes e-mail adresës ka paraqitur edhe një pretendim tjetër për thirrje të parregullt në seancës, ku sipas tij me datë 24 Maj 2024 në kundërshtim me nenin 172 par.2, 474 par.1, 2 përmes telefonit, një person i pa prezentuar me emër dhe mbiemër nga zyra e gjyqtarit, e ka telefonuar dhe e ka njoftuar në lidhje me caktimin e seancës për datë 27.05.2024, pra vetëm dy ditë para mbajtjes së seancës.

Gjyqtari i çështjes në lidhje me ankesën e parashtruar ka deklaruar në lidhje me të gjitha pretendimet e paraqitura, ku sipas tij sa i përket mos dorëzimit në mënyrë të rregullt të aktakuzës, i pandehuri duhet ti drejtohet Prokurorisë Themelore si organ kompetent, ndërsa sa i përket pretendimeve se është gjykuar dhe dënuar pa prezencën e tij, gjyqtari ka deklaruar se në rastin konkret kemi të bëjmë me urdhër ndëshkimor i cili merret në harmoni me neni 495 të KPPRK-së (jashtë seance dhe pa u ftuar i pandehuri), dhe posa i njëjti ka parashtruar kundërshtim është caktuar seanca dhe rasti fillon të gjykohet në procedurë të rregullt. Në lidhje me pretendimet e të pandehurit se gjyqtari i rastit dhe stafi mbështetës nuk janë mjaftuar me shpalljen fajtor por edhe e kanë dërguar aktgjykimin në vendin e punës, gjyqtari ka deklaruar se në shpalljen fajtor të të pandehurit vendos vetëm gjyqtari i çështjes dhe asnjë staf tjetër i zyrës, ndërkaq pjesa tjetër e stafit vepron në bazë të udhëzimeve të gjyqtarit në hartim të drafteve të caktuara. Ndërkaq, aktgjykimin në fjalë ju është dërguar palës në adresën sipas aktakuzës, ku adresa e vendbanimit ka qenë Fushë Kosovë. Sipas tij, të dhënat dhe adresa se ku i dërgohet gjykimin janë marr nga aktakuza dhe janë si në vijim: Ndaj të akuzuarit: L.TH, nga babai I. dhe nëna Sh., i lindur më datë -----, në -----, me adresë të banimit në -----, me numër personal të letërnjoftimit -----, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shkollimi i mesëm, profesioni Politolog, i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, kurrfarë adrese tjetër nuk ka cekur në aktgjykimin përfshirë edhe ku i njëjti mund të punonte (shihe aktgjykimin). Ndërkaq, sipas gjyqtarit vendimi ju është dërguar me postë në Fushë Kosovë jo në “----“, ndërsa pse ju paska hapur zarfi në “----“, sigurisht i pandehuri duhet të fillojë procedurat se pse është hapur zarfi nga ana e tyre kur ka pasur të bëjë me dërgesë personale. Po ashtu ndër të tjera ka deklaruar se gjyqtari nuk merret me dërgimin e shkresave. Sipas tij, gjykata ka pasur të dhënat sipas aktakuzës dhe të njëjtat i ka vendosur edhe në aktgjykim, ndërsa asnjëherë i njëjti nuk është thirrur si figurë publike, por vetëm si i

pandehur. Sipas gjyqtarit, asnjëherë i njëjti nuk do të trajtohet si fytyrë publike sepse nuk ka relevancë për gjykatën. Sa i përket pretendimet se i pandehuri paska njohur dikë nga stafi i zyrës së tij, i njëjti duhet të deklarohet se kë nga ata njeh me emër dhe mbiemër e nëse ka arsye atëherë të kërkoj përjashtimin pjesëtarit të stafit të gjyqtarit a po edhe përjashtimin e gjyqtarit sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket mbylljes së seancës, gjyqtari është deklaruar se ka respektuar vullnetin e palës së dëmtuar duke marrë parasysh ndjeshmërinë e rastit, pasi që rasti dyshohet të ketë ndodhur ndaj viktimës së ndjeshme dhe brenda marrëdhënies familjare pasi që e dëmtuara kishte qenë në lidhje dashurie me të pandehurin. Gjyqtari i çështjes ka deklaruar se i kishte lejuar të pandehurit incizimin zanor të seancës por jo edhe incizimin me video a po fotografimin, duke i bërë të ditur të pandehurit se kjo lejohet vetëm për mbrojtje më efikase ose më të mirë siç i njëjti pretendonte, por meqenëse i njëjti nuk e ka respektuar vendimin e gjykatës atëherë kam marrë veprim tjetër për ruajtje të rendit dhe qetësisë, me qëllim të respektimit të palës tjetër në procedurë. Tutje gjyqtari i rastit ka deklaruar se gjykata nuk vepron me dy standarde, nëse i pandehuri është ndier keq që i është shqiptuar urdhër ndëshkimor pasi që i njëjti është figurë publike, duhet ta ketë parasysh që edhe e dëmtuara mund ta ketë po këtë ankesë. Tutje gjyqtari ka deklaruar se gjykata vendos në bazë të provave dhe fakteve, gjithmonë duke respektuar ligjin i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, në mënyrë të pavarur dhe të papengueshme. Ndërsa sa i përket pretendimit të paraqitur më vonë përmes e-mail adresës në lidhje me thirrjen në seancë përmes telefonit dy ditë para mbajtjes së seancës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se i njëjti është ftuar me ftesë por pasi që nuk është kthyer asnjë fletë kthesë, në harmoni me nenin 172 të KPRK-së, e kanë njoftuar të njëjtin se e ka seancën e caktuar, kjo ka mbështetje edhe në vet të thënat e të pandehurit i cili kur ka ardhur për të parashtruar kundërshtimin ka deklaruar se dëshiron që ta përfundoj sa më shpejtë këtë lëndë, ku edhe vet në këtë ankesë ka pohuar se mund të kontaktohet në të dhënat e tij që i ka publike, madje edhe ka pohuar se kontaktet e tij gjenden shumë lehtë në google a po edhe në web faqen zyrtare të -----, ku i njëjti përveç kësaj në disa parashtrësia e ka lënë vet numrin kontaktues të telefonit dhe ka kërkuar që të ftohet edhe përmes telefonit. Në fund, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se i pandehuri duhet të respektoj dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, ndërsa është zotuar se do të ndjek një proces të rregullt dhe të paanshëm, në harmoni me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga parashtruesi i ankesës, Autoriteti Kompetent ka kërkuar deklaratë edhe nga bashkëpunëtori i zyrës A.S, i cili ka deklaruar se të gjitha lëndët të cilat pranohen në zyre fillimisht shqyrtohen nga ana e gjyqtarit të çështjes, i cili bënë shqyrtimin paraprak dhe vendos për sanksionin, e më pas i delegon lëndët tek bashkëpunëtori për përpilim të aktgjykimit. Sipas tij, hartimin e vendimeve dhe shkresave të ndryshme gjyqësore, qofte: Kërkesa, urdhëresa, aktvendime, aktgjykime, si bashkëpunëtorë i bënë brenda autorizimeve të tij, si dhe në harmoni me rregulloren e nxjerr nga KGJK-së, nr. 15/2022 të datës 10.01.2023, saktësisht në nenin 15 të kësaj rregullore ku decidivisht në par.1 pika 1.1 citohet se: *Bashkëpunëtori profesional i gjykatës me kërkesë të gjyqtarit, bënë hartimin e vendimeve gjyqësore si, aktgjykimeve, aktvendimeve, urdhëresave, si dhe shkresave të tjera.* Tutje i njëjti ka deklaruar se në asnjë aspekt dhe asnjë rast nuk ndikon në vendimmarrjen e gjyqtarit, mirëpo gjithnjë punon dhe vepron në harmoni me kompetencat dhe autorizimet të cilat i ka dhënë ligji. Sipas tij, gjate periudhës kur gjyqtari S.S, ka qenë në trajnim jashtë vendi, i akuzuari L.TH është paraqitur në zyrën e gjyqtarit S.S, në të cilën zyre i njëjti është i angazhuar si bashkëpunëtor profesional. Sipas tij, i akuzuari L.TH kishte hyrë në zyrën e gjyqtarit S.S dhe

e kishte mbyllur derën dhe iu është drejtuar me fjalët “kam për të diskutuar pak”, ndërsa ky ju kishte përgjigjur, “ne rregull, vetëm se leje derën te hapur, se nuk kemi për të diskutuar asgjë fshehur”, i akuzuari pas kësaj i është drejtuar me fjalë se, “a po me njeh dhe a me ke pare në televizion”, ku i njëjti ju është përgjigjur, “jo nuk po te njoh dhe nuk të kam parë asnjëherë”, mirëpo çfarë ke për të diskutuar? I akuzuari L.TH sipas tij është përgjigjur se e kam një Aktgjykim të cilin e ka lëshuar gjyqtari dhe për këtë çështje nuk ndihem fajtor, pasi që ky aktgjykim është nxjerrë pa prezencën time në gjykatë. Sipas bashkëpunëtorit profesional i njëjti është përgjigjur se: *lidhur me vendosjen e çështjes është kompetent gjyqtari dhe nuk kam të drejtë që të diskutoj për vendosmërinë e çështjes, ndërsa sa i përket pakënaqësisë lidhur me aktgjykimin e ke të drejtën e kundërshtimit, mandej gjyqtari cakton seancën dhe ju fton edhe juve si i akuzuar me ftesë të rregullt.* Tutje ka deklaruar se i akuzuari kishte shkuar, ndërsa ka ardhur prape, dhe e ka pyetur a me ftoni sigurt për seancë, sepse kam për të udhëtuar dikund jashtë vendit, unë prape ju kam përgjigjur, *po, sepse nuk mundemi me vazhdu tutje me procedurën, pa qene ti i pranishëm ne seance, sepse këtë e rregullon Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.* Në fund ka deklaruar se palën e akuzuar L.TH, çështja e të cilit është duke u gjykuar nga gjyqtari me të cilin punon nuk e njeh as në aspektin personal e as familjar, si dhe më të njëjtin nuk është takuar ndonjëherë, as në mënyre të drejtpërdrejt e as në mënyre indirekte, përveç kur i njëjti ka ardhur në zyrën ku i njëjti punon për të marrë sqarim lidhur me çështjen dhe te njëjtin e ka parë vetëm në seanca gjyqësore.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit S.S.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në referim të pretendimit të paraqitur nga ankuesi se është dënuar për veprën penale “Ngacim” pa qenë fare në dijeni ose i informuar për veprën a po shkakun, Autoriteti Kompetent në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se gjyqtari i çështjes ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara, pasi që aktakuza e ngritur nga Prokurori i Shtetit ka qenë Aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, ku sipas nenit 493 të KPPRKS-së, parashihet se për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t’i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor. Në rastin konkret, bazuar në dispozitat ligjore dhe autorizimet e dhëna gjyqtari i çështjes ka nxjerrë aktgjykimin me urdhër ndëshkimor.

Duke marrë parasysh faktin se këto lëndë vendosen pa shqyrtim gjyqësor, të njëjtat mund të shqyrtohen dhe vendosen në një kohë të shkurtër nga ana e gjyqtarit të çështjes. Pretendimet në lidhje me nxjerrjen e shpejtë të aktgjykimin nga ana e gjyqtarit të çështjes, është mënyra e organizimit të tij të punës dhe si pretendim nuk mund të hyjë në domenin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarit.

Sa i përket pretendimit se gjyqtari i rastit së bashku me stafin e tij kanë dërguar aktgjykimin në vendin e tij të punës, nga deklarata e gjyqtarit por edhe nga vet kopja e fletë dërgesës shihet se pjesa e “-----” është shënuar me një tjetër drejtshkrim dhe është shënuar në vend tjetër ku është e destinuar adresa e të pandehurit, ndërkaq gjyqtari i çështjes ka deklaruar se nga zyra e tij ky aktgjykim është dërguar vetëm në adresën Fushë Kosovë ashtu siç është dhënë në aktakuzë. Andaj, duke marrë parasysh se shkresat e gjykatës dërgohen përmes Postës së Kosovës, Autoriteti Kompetent nuk ka arritur të gjejë mekanizëm që do të dëshmonte rrjedhën e dërgimit të vendimit.

Por, po ashtu është e rëndësishme të ceket se gjyqtari i çështjes nuk është përgjegjës për ekspedimin e vendimeve gjyqësore, andaj pretendimet e tilla nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për të njëjtin.

Sa i përket pretendimit dhe aludimeve se i pandehuri këtu parashtruesi i ankesës ka njohur ndonjë nga stafi i zyrës së gjyqtarit dhe nuk ishin rastësi këto veprime duke aluduar në bashkëpunëtorin profesional, Autoriteti Kompetent nuk ka arritur që të provoj një të dhënë të tillë pasi që vet ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë relevante se në çfarëdo mënyre e njeh ndonjërin nga stafi i zyrës së gjyqtarit a po se këto veprime kanë qenë të qëllimshme nga ndonjëri nga ta, ndërsa bashkëpunëtori profesional i gjyqtarit ka deklaruar se nuk është takuar dhe nuk e njeh të njëjtin as personalisht e as profesionalisht, përpos si i akuzuar në lëndën në fjalë. Por, Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se stafi i zyrës së gjyqtarit në çdo rast vepron vetëm brenda autorizimeve dhe kompetencave të dhëna nga ana e gjyqtarit të çështjes, që do të thotë se gjyqtari është ai i cili delegon detyrat te bashkëpunëtori profesional a po te stafi tjetër i zyrës, andaj të njëjtit nuk kanë asnjë kompetencë vendimmarrëse.

Sa i përket pretendimeve se gjyqtari i çështjes në kundërshtim me legjislacionin në fuqi ka marrë vendim për mbylljen e seancës gjyqësore të datës 09.02.2024, Autoriteti Kompetent në shkresat e lëndës ka gjetur se gjyqtari i çështjes ka nxjerrë vendimin P.nr.2929/23 të datës 09.02.2024 sipas të cilit ka mbyllur seancën, ku po ashtu i ka lënë të drejtën palës për ankesë sipas legjislacionit në fuqi, me rastin e ankimimit të aktgjykimit.

Sa i përket pretendimit tjetër se gjyqtarit S.S ka lejuar fillimisht incizimin e më pastaj e ka ndërprerë seancën dhe e ka njoftuar prokurorin e shtetit për inicim të procedurës penale për incizim të paautorizuar, Autoriteti Kompetent ka gjetur se gjyqtari i çështjes është i detyruar të kujdeset për zbatimin e akteve normative në mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës. Kjo sepse, gjyqtari çdo herë duhet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.

Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se pretendimet e parashtruara nga i njëjti mund të jenë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen me ankesë në Gjykatën e Apelit, pasi të merret vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen gjyqësore. Gjykata e Apelit si shkallë e dytë është kompetente që të shqyrtoj sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafit 1 të këtij Kodi ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

AD/GJTHPR/09/24, me datë 13.06.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë